



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Nr.430/2022

Në bazë të nenit 105 pika 1 dhe 2 dhe nenin 108/A të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 05/ L-068, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 05/ L-092, nenin 4 i “Rregullave të paraqitjes së Kërkesës për Rishqyrtim pranë Autoritetit Kontraktues, parashtrimi të ankesave pranë OSHP-së, dhe vlera e tarifave të ankesave”, si dhe nenin 17 paragrafi 3 të Rregullores së Punës së OSHP-së nr. 01/2020, me numër të protokollit 83/2020, pas shqyrtimit të ankesës së OE “AILBKOS SAFETY” SH.P.K. me adresë Rruga e Pejës nr. 26 Fushë Kosovë, për aktivitetin me titull “Furnizim me pajisje zjarrfikëse për nevojat e BZ në Mitrovicë” me Nr. prokurimi 214-2022/642-22-5108-1-2-1 iniciuar nga AK - Komuna e Mitrovicës, Kryesuesi i Sekretariatit të Organit Shqyrtues të Prokurimit z. Ardian Behra me datën: 08 shtator 2022 mori këtë :

VENDIM

- I. Hedhet si e pa lejuar ankesa e OE “AILBKOS SAFETY” SH.P.K. me adresë Rruga e Pejës nr. 26 Fushë Kosovë, për aktivitetin me titull “Furnizim me pajisje zjarrfikëse për nevojat e BZ në Mitrovicë” me Nr. prokurimi 214-2022/642-22-5108-1-2-1 iniciuar nga AK - Komuna e Mitrovicës.**
- II. I LEJOHET autoritetit kontraktues – Komuna e Mitrovicës që të vazhdoj më tutje**

me aktivitetin e prokurimit me titull: “Furnizim me pajisje zjarrfikëse për nevojat e BZ në Mitrovicë” me Nr. prokurimi 214-2022/642-22-5108-1-2-1 (përkitazi me këtë ankese nëse nuk ka ankese tjetër).

- III.** Në përputhje me nenin 31 pika 4, të Rregullores së Punës së OSHP-së operatorit ekonomik ankues i kthehet tarifa e ankesës. OE ankues obligohet që konform nenit 31 pika 6 të Rregullores të Punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjnë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën iu bëhet konfiskimi i depozitës, dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

ARSYETIM

Organi Shqyrtues i Prokurimit në sistemin elektronik me datë 02.09.2022 , ka pranuar ankesë nga OE “AILBKOS SAFETY” SH.P.K. me adresë Rruga e Pejës nr. 26 Fushë Kosovë, për aktivitetin me titull “Furnizim me pajisje zjarrfikëse për nevojat e BZ në Mitrovicë” me Nr. prokurimi 214-2022/642-22-5108-1-2-1 iniciuar nga AK - Komuna e Mitrovicës, ankesë kjo e protokolluar me numër të protokollit 430/2022.

Organi Shqyrtues i Prokurimit sqaron se për aktivitetin e prokurimit “Furnizim me pajisje zjarrfikëse për nevojat e BZ në Mitrovicë” me Nr. prokurimi 214-2022/642-22-5108-1-2-1 AK Komuna e Mitrovicës me datën 13.06.2022 , ka publikuar Njoftimin për kontratë. OSHP me ditën 19.08.2022 merr vendim nr. PSH 249/2022.

Në bazë të këtij vendimi autoriteti kontraktues me 29.08.2022, ka publikuar Njoftim për Informata Shtesë ose Përmirësim i Gabimeve (i titulluar në e-prokurim si B54 Formulari Standard për korrigjim te gabimeve në njoftimet e publikuara) , te cilin Njoftim figuron se afati i fundit për dorëzimin e ofertave dhe si date për hapjen e ofertave është data: 05.09.2022 ora 14:00.

OE “AILBKOS SAFETY” SH.P.K. me adresë Rruga e Pejës nr. 26 Fushë Kosovë, me datën 01.09.2022 ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim në autoritetin kontraktues.

Me datën 02.09.2022 OE “AILBKOS SAFETY” SH.P.K. me adresë Rruga e Pejës nr. 26 Fushë Kosovë ka parashtruar ankesë në OSHP.

Organi Shqyrtues i Prokurimit konstaton se nga provat e prezantuara vërehet se OE “AILBKOS SAFETY” SH.P.K. me adresë Rruga e Pejës nr. 26 Fushë Kosovë, për aktivitetin me titull “Furnizim me pajisje zjarrfikëse për nevojat e BZ në Mitrovicë” me Nr. prokurimi 214-2022/642-22-5108-1-2-1 iniciuar nga AK - Komuna e Mitrovicës, ka humbur afatin ligjor për parashtrim të kërkesës për rishqyrtim sepse hapja e ofertave është planifikuar të behet me datën 05.09.2022 ora 14:00h, kurse kërkesa për rishqyrtim nga OE ankues është dorëzuar në AK me datën 01.09.2022, nga kjo rrjedh se OE ankues ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim katër ditë para hapjes së ofertave, e jo së paku pesë (5) ditë para afatit të fundit për dorëzim të ofertave siç parashihet me ligj.

Organi Shqyrtues i Prokurimit sqaron se paragrafin 3 të nenit 108/A i Ligjit për Prokurim Publik dhe nenit 4 i “Rregullave të paraqitjes së Kërkesës për Rishqyrtim pranë Autoritetit Kontraktues, parashtrimin të ankesave pranë OSHP-së, dhe vlera e tarifave të ankesave specifikon:

- a) *Kurdo qe kërkesa për rishqyrtim ka te beje me njoftimin e kontratës ose me dokumentet e tenderit se paku pesë (5) ditë para afatit të fundit për dorëzim të ofertave.*
- b) *Kurdo qe kërkesa për rishqyrtim ka te beje me vendimin për dhënie të një kontratë ose te një konkursi te projektimit brenda afatit prej pesë (5) ditëve pas datës së njoftimit për dhënien e kontratës ose njoftimit mbi rezultatet e konkursit te projektimit që i është dërguar ankuesit.*
- c) *Kurdo qe kërkesa për rishqyrtim ka te beje me vendimin për anulimin e procedurës së prokurimit, brenda pesë (5) ditëve nga data kur aktiviteti I prokurimit është anuluar zyrtarisht përmes njoftimit për anulim.*

Prandaj duke u nisur nga sqarimet e dhëna si më lart OSHP konstatojmë se ankesa e parashtruar

në OSHP nga OE: "AILBKOS SAFETY" SH.P.K. me adresë Rruga e Pejës nr. 26 Fushë Kosovë, për aktivitetin me titull "Furnizim me pajisje zjarrfikëse për nevojat e BZ në Mitrovicë" me Nr. prokurimi 214-2022/642-22-5108-1-2-1 iniciuar nga AK - Komuna e Mitrovicës, e datës 02.09.2022 me numër të Protokollit 430/2022, hedhet si e pa lejuar sepse ankuesi kërkesën për rishqyrtim e ka parashtruar në kundërshtim me nenin 108/A të Ligjit për Prokurim Publik dhe nenit 4 i "Rregullave Rregullat e paraqitjes së kërkesës për rishqyrtim pran autoriteti kontraktues, parashtrimi të ankesave pran OSHP-së, dhe vlera e tarifave të ankesave, andaj e njëjta ankesë hedhet si e pa lejuar dhe nuk hynë në shqyrtim nga OSHP.

Kryesuesi i Sekretariatit të OSHP-së, duke u bazuar në atë që u tha si më lartë, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

1x1 AK Komuna e Mitrovicës ;

1x1 OE "AILBKOS SAFETY" SH.P.K. me adresë Rruga e Pejës nr. 26 Fushë Kosovë;

1x1 Arhivës së OSHP-së

1x1 Për publikim në web- faqe të OSHP-së

